



Raporti Mujo

Shkurt 2010

- **01 shkurt 2010** – Takim ZRRE-KEK lidhur me aplikacionet preliminare për të Hyra të Lejuara dhe Tarifa;
- **02 shkurt 2010** - Takim- dhënie e informacioneve të interesuarve për prodhim të energjisë nga burime të ripërtëritshme;
- **02 shkurt 2010** - Shqyrtimi dhe analizimi i draft procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë termike;
- **03 shkurt 2010** – Takim ZRRE-KOSTT lidhur me shqyrtimin e tarifave të energjisë elektrike;
- **04 shkurt 2010** - Takim me përfaqësuesin e KELKOS z. George Weber e lidhur me investimet e mundshme në HC e vogla;
- **05 shkurt 2010** - Takim i stafit të ZRRE lidhur me vlerësimin dhe komentimin e Procedurës për Leximin dhe Faturimin e konsumatorëve tarifor;
- **05 shkurt 2010** – Pjesëmarrje e anëtarit të DTÇ në takimin e mbajtur në MEM lidhur me draft modelin e tregut;
- **08 shkurt 2010** - Takim me përfaqësues të Wind Power e lidhur me aplikacionin e kësaj kompanie për ndërtim të gjeneratorit që do të prodhojë energji elektrike nga era, në lokacionin Bostan, Novo Bërdë;
- **08 shkurt 2010** - Takim i stafit të ZRRE lidhur me komentet e konsulentëve të transaksionit për projektin “Kosova e Re”;
- **09 shkurt 2010**– Futja e të dhënave financiare dhe energjetike në modelin e të hyrave dhe tarifave pas aplikimit final;
- **10 shkurt 2010** - Përgatitja e vendimit final për aprovimin e çmimeve për shërbimet e rrejtit sekondar të NQ Termokos;
- **11 shkurt 2010** - Shqyrtimi i Raportit vjetor për te licencuarit (TM4) te dërguar nga NQ Gjakova se bashku me planin e biznesit 2010; përgatitja e komenteve për planin e biznesit;
- **11 shkurt 2010** – Dorëzimi i kërkesës KEK Sha dhe KOSTT Sha për dhënie sqarimeve shtesë mbi SHTE4;
- **12 shkurt 2010** - Takim me përfaqësuesin nga Zyra e Auditorit Gjeneral, Enver Ramadani lidhur me raportimet që NQ Termokos i dorëzon në ZRRE. Me pas me datën 26 shkurt 2010 i janë percjellur me email informatat nevojshme rreth raporteve tre mujore te pajtueshmërisë me licencat së NQ Termokos;
- **12 shkurt 2010** - Takim me përfaqësuesit e KTW lidhur me aplikacionin për ndërtim të gjeneratorit që do të prodhojë energji elektrike nga era;
- **12 shkurt 2010** - Takim i stafit të ZRRE me përfaqësues të KEK sh.a e lidhur me shkyçjet kolektive etj.;
- **12 shkurt 2010** - përfaqësuesit e DMK kanë marrë pjesë në një takim me përfaqësuesit e KEK-ut lidhur me shkyçjet grupore, takimi është mbajtur në lokalet e ZRRE-së;
- **15 shkurt 2010** - Takim - Dorëzimi i raporteve TM2, TM3 dhe Vjetor nga përfaqësuesi i kompanisë KelKos;
- **15 shkurt 2010** - Takim me përfaqësuesit e MMPH lidhur me çështjet që lidhen me zbatimin e Rregullit për Autorizim;
- **15 shkurt 2010** – Takim ZRRE-KOSTT lidhur me shqyrtimin e tarifave të energjisë elektrike;
- **16 shkurt 2010** – Takim ZRRE-KEK lidhur me shqyrtimin e tarifave të energjisë elektrike 2010 ;
- **16 shkurt 2010** – Takim ZRRE-KEK lidhur me Sqarimet e dërguara KEK-ut mbi kalkulimin RAB dhe RAB;



- **19 shkurt 2010** – Llogaritje në vlera fizike dhe monetare mbi faturimin, inkasimin dhe humbjet e energjisë elektrike për vitet 2008/2009;
- **23 shkurt 2010** - Takim i stafit të ZRRE me përfaqësues të IFC e lidhur me rolin e ZRRE në ndërtimin e TC “Kosova e Re” dhe në privatizimin e Distribuimit dhe Furnizimit;
- **23 shkurt 2010** - Trajnim- Përmirësimi i aftësive të Komunikimit dhe Zhvillimi i një Projekt-propozimi të komunikimit;
- **23 shkurt 2010** - Trajnim- Takimet Efektive;
- **23 shkurt 2010** - përfaqësuesit e DMK kanë marrë pjesë në një takim me përfaqësuesit e KEK-ut lidhur me procedurën e shkyçjes dhe rikyçjes së konsumatorëve në sektorin e energjisë;
- **23 shkurt 2010** - përfaqësuesit e DMK kanë marrë pjesë në një takim lidhur me propozimin e kualitetit të standardeve me konsultantët e NERA-s;
- **23 shkurt 2010** - Përgatitja e Raportit vjetor të ZRRE – mbledhja dhe azhurnimi i të dhënave aktuale për sezonin raportuese 2008/2009 si dhe nxjerrja e çmimit të mazutit nga bursat ndërkombëtare si dhe çmimin e përafërt të ngrohjes qendrore në rajon;
- **24 shkurt 2010** - Takim me përfaqësues të CEZ nga Shqipëria e lidhur me tregun e energjisë elektrike në Kosovë;
- **25 shkurt 2010** - përfaqësuesit e DMK kanë marrë pjesë në një takim lidhur me propozimin e kualitetit të standardeve me konsultantët e NERA-s;
- **25 shkurt 2010** - përfaqësuesit e DMK kanë marrë pjesë në takimin e radhës të Grupit Punues në propozimin e Standardeve të kualitetit, takimi është mbajtur në lokalet e ZRRE-së;
- **26 shkurt 2010** – publikimi i Raportit Konsultativ -Shqyrtimi i Katërt i Tarifave të Energjisë Elektrike 2010 (SHTE4) për palët e interesit;
- **26 shkurt 2010** – Publikimi i Deklaratës për Shtyp mbi Raportin Konsultativ SHTE4;
- **26 shkurt 2010** - Përgatitja e dokumentacionit për pjesëmarrje në takimin në mes QKUK-Termokos –ZRRE, lidhur me borxhin e energjisë elektrike në nënstacionin e ngrohjes në rajonin e spitalit DIFD. ZRRE këtu ka kryer rolin e saj vëzhgues , për të qenë kështu në ngjarje me rrjedhën e kontestit.
- **26 shkurt 2010** - Takim: Grupi Punues mbi standardet e Kualitetit të Furnizimit dhe Shërbimit (KEK-MEM-ZRRE-KOSTT);
 - ✓ Gjatë muajit shkurt 2010 DMK ka regjistruar **29** ankesa të konsumatorëve, ka zgjidhur **33** ankesa të konsumatorëve (**29** – Vendime dhe **4** – lëndë pasive).
 - ✓ Gjatë muajit shkurt 2010 ka pasur **90** biseda direkte me palë dhe **10** biseda telefonike me palët.